

“ikubINFO” shpk

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

Së bashku me Raportin e Audituesit të Pavarur

PËRMBAJTJA:

	FAQE
RAPORTI I AUDITUESIT TË PAVARUR	1
PASQYRAT FINANCIARE:	
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	2
PASQYRA E PERFORMANCËS	3
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	4
PASQYRA E FLUKSIT TË MJETEVE MONETARE	5
SHËNIMET SHPJEGUESE TË PASQYRAVE FINANCIARE	6 - 21

RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR

Drejtuar: Menaxhimit dhe ortakëve të Shoqërisë ikubINFO sh.p.k

Raport mbi Pasqyrat Financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëngjitur të shoqërisë ikubINFO sh.p.k (më poshtë "Shoqëria") të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2015, pasqyrën e performancës, pasqyrën e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrën e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara dhe për ato kontrole të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e Audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne e kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të respektojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë e kryejmë auditimin për të arritur sigurinë e arsyeshme për faktin nëse pasqyrat financiare janë pa anomali materiale.

Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për të siguruar evidencën e auditimit rreth shumave dhe informacioneve shpjeguese të dhëna në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, përfshirë vlerësimin e rreziqeve të anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë bërjes së këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që ka të bëjë me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit, në mënyrë që të përcaktojë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinion mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit.

Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura dhe të arsyeshmërisë së çmuarjeve kontabël të bëra nga drejtimi, sikurse edhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në të gjitha aspektet materiale, në mënyrë të drejtë, pozicionin financiar të **ikubINFO sh.p.k** më datën 31 dhjetor 2015, performancën e saj financiare dhe flukset e parash për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara.



Zhuljeta Vehbi
Partner Angazhimi

27 mars 2016

 **MAZARS**
Rr. Emin Duraku, Pall. "Binjaket",
No.5, 1000, Tirana, Albania
phone : +355 42 27 80 15
www.mazars.al , info@mazars.al

Mazars shpk

Rr. Emin Duraku - Pall. "Binjaket" N°5 - Tirana, Albania

Tel/Fax: +355 42 278 015 - Extension N° 111

www.mazars.al


Praxity
GLOBAL ALLIANCE OF
INDEPENDENT FIRMS

"ikubINFO" shpk*(Vlerat janë në Lek)***Pasqyra e Pozicionit Financiar
më 31 dhjetor 2015**

	Shënime	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
AKTIVET			
Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare	4	101,192,000	80,887,870
Llogari të arkëtueshme tregtare	5	132,699,011	30,313,812
Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura	6	12,104,110	2,673,707
Të tjera llogari të arkëtueshme	7	196,000	898,119
Inventari	8	-	1,800,000
Shpenzime të shtyra	9	3,312,211	-
Total Aktive afatshkurtra		249,503,332	116,573,508
Aktivitet afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	10	10,435,605	8,143,957
Total aktive afatgjata		10,435,605	8,143,957
Total aktive		259,938,937	124,717,465
DETYRIMET			
Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme tregtare	11	16,140,952	13,750,167
Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura	12	83,864,171	3,059,343
Detyrime tatimore	13	49,476,230	18,718,687
Të tjera detyrime	14	43,832,965	44,004,733
Total detyrime afatshkurtra		193,314,318	79,532,930
Detyrime afatgjata			
Total detyrime afatgjata		-	-
Totali i detyrimeve		193,314,318	79,532,930
KAPITALI			
Kapitali i nënshkruar		4,200,000	4,200,000
Rezerva ligjore		420,000	-
Fitimi i ushtrimit		62,004,619	40,984,535
Total kapitali		66,624,619	45,184,535
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	15	259,938,937	124,717,465

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyra e Performancës

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit	16	470,444,784	314,705,293
Të ardhura të tjera të shfrytëzimit	17	(824,254)	135,485
Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme		(181,336,775)	(83,448,098)
1) Lënda e parë dhe materiale të konsumueshme	18	(154,309,886)	(66,138,136)
2) Të tjera shpenzime	19	(27,026,889)	(17,309,962)
	19		0
Shpenzime të personelit	20	(212,447,362)	(181,049,684)
1) Paga dhe shpërblime		(203,602,205)	(173,746,224)
2) Shpenzime të sigurimeve shoqërore/shëndetsore		(8,845,157)	(7,303,460)
Shpenzime konsumi dhe amortizimi		(2,416,234)	(1,958,725)
Shpenzime të tjera të shfrytëzimit	21	(5,286)	(1,243)
Të ardhura të tjera			
Shpenzime financiare	22	77,574	12,886
1) Shpenzime interesi dhe shpenzime të ngjashme		2,970	12,886
2) Shpenzime të tjera financiare		74,604	-
Fitimi/humbja para tatimit		73,492,447	48,395,914
Shpenzimi i tatimit mbi fitimin	23	(11,487,828)	(7,411,379)
Shpenzimi aktual i tatimit mbi			
1) fitimin		(11,487,828)	(7,411,379)
Fitimi/humbja e vitit		62,004,619	40,984,535
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin:		-	-
Totali i të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		-	-
Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin		62,004,619	40,984,535

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

"ikubINFO" shpk
(Vlerat janë në Lek)

Pasqyra e ndryshimeve në Kapital
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015

	Kapitali i nënshkruar	Rezerva Ligjore	Rezerva të tjera	Fitim / Humbja e vitit	Totali
Pozicioni financiar më 1 janar 2014	4,200,000	-	-	44,692,800	48,892,800
Të ardhura totale gjithëpërfshirëse për vitin:				40,984,535	40,984,535
Lëvizjet përmes kapitalit			44,692,800	(44,692,800)	-
Dividendë të paguar			(44,692,800)		(44,692,800)
					-
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2014	4,200,000	-	-	40,984,535	45,184,535
Totali i të ardhura gjithëpërfshirëse për vitin:				62,004,619	62,004,619
Lëvizjet përmes kapitalit		420,000	40,564,535	(40,984,535)	-
Dividendë të paguar			(40,564,535)		(40,564,535)
Pozicioni financiar më 31 dhjetor 2015	4,200,000	420,000	-	62,004,619	66,624,619

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 janë aprovuar nga administratori ikubINFO shpk më 28.03.2016 dhe janë firmosur si më poshtë.



Romeo SHERKO
Romeo SHERKO
Administrator

**Pasqyra e Fluksit të Mjeteve Monetare
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015**

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Flukset e parasë nga aktivitetet operative		
Fitim / Humbja e vitit	62,004,619	40,984,535
Rregullimet për shpenzimet jomonetare:		
Shpenzimet financiare jomonetare	606,864	(669,669)
Shpenzimet për tatimin mbi fitimin jomonetar	4,864,467	1,076,110
Shpenzime konsumi dhe amortizimi	2,416,234	1,958,725
Rënie/(rritje) në të drejtat e arkëtueshme dhe të tjera	(114,425,694)	4,404,008
Rënie/(rritje) në inventarë	931,927	-
Rritje/(rënie) në detyrimet e pagueshme	110,548,207	12,612,292
Rritje/(rënie) në detyrime për punonjësit	(763,213)	43,864,553
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e shfrytëzimit	66,183,411	104,230,554
Fluksi i mjeteve monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit		
Pagesa për blerjen e aktiveve afatgjata materiale	(4,707,884)	(3,424,062)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e investimit	(4,707,884)	(3,424,062)
Fluksi i mjeteve monetare nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit		
Dividendë të paguar	(40,564,535)	(44,692,800)
Mjete monetare neto nga/(përdorur në) aktivitetin e financimit	(40,564,535)	(44,692,800)
Rritje/(rënie) neto në mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare	20,910,992	56,113,692
Mjete monetare dhe ekuivalentë të mjeteve monetare më 1 janar	80,887,870	24,104,509
<i>Efekti i luhatjeve të kursit të këmbimit të mjeteve monetare</i>	(606,862)	669,669
Mjete monetare dhe ekuivalentë më 31 dhjetor	101,192,000	80,887,870

4

Pasqyrat financiare duhet të lexohen së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 6 deri në 21, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacion i përgjithshëm

Shoqëria "ikubINFO" Shpk është regjistruar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar pranë regjistrave të Qendrës Kombëtare të Regjistrimeve më datë 12.05.2011. Veprimtaria e saj rregullohet sipas dispozitave përkatëse të ligjit Nr.7638 datë 19 Nentor 1992 "Për Shoqëritë Tregtare" dhe statuti i saj.

Kapitali Themeltar i shoqërisë është 4,200,000 Lek i zotëruar nga ortakët si më poshtë:

- Investment SHERKO - ikub GROUP 41.5%
- Armand Shara 28%
- Elton Ropi 15%
- Albano Qojle 15.5%

Administrator i shoqërisë është Z.Romeo Sherko.

Selia e shoqërisë ndodhet në rrugën Abdyl Frasheri, EGT Tower, Pallati 11/1, Tiranë. Ajo është e regjistruar në Degën e Tatimeve, Tiranë më NIPT L11712002T.

Aktiviteti kryesor i kësaj shoqërie janë " I. Aktiviteti i zhvillimit të software aplikative. 1.1 Në platforma Net. Java, Web Assembler.1.2 Në fushën e Taksave, Content Management, Portale, Interoperabilitet, e të tjera të përafërta. Aktiviteti i shërbimeve mbi software aplikative të zhvilluara nga vetë Shoqëria ikubInfoSoft, ose software të tjera ku ka kompetence.3. Aktiviteti i implementimit të sistemeve Database, Middleware, BI, Data Warehouse dhe platformave që shërbejnë për zhvillime aplikacionesh, objekt i veprimtarisë së ikubInfoSoft shpk. 4. Trajnime dhe Kurse të Formimit Profesional për çdo specialitet që lidhet me aktivitetet e ikubINFO shpk". 5. Aktiviteti i konsulencës në fushën e software aplikativë. 6. Aktiviteti i Solution Design për software aplikative. 7. Aktiviteti i Manaxhimit të Projekteve me komponentë që bëjnë pjesë në pikat 1, 2, 3, 4, 5, 6. 8. Aktiviteti i Manaxhimit të Projekteve me objekt ICT. 9. Aktiviteti i shitjes së produkteve dhe shërbimeve që ka në objektin e veprimtarisë. 10. Aktiviteti i shitjes së pajisjeve ICT. II.Aktiviteti i shitjes së licencave software dhe shërbimeve përkatëse të lidhura me to. 12. Software si shërbim. 13. Aktivitet në shërbime të adoptimit dhe të përshtatjes së softwareve. 14. Aktivitet në shërbime të përpunimit të të dhënave. 15. Aktivitet në shërbime të hostimit të bazave të të dhënave dhe të dhënave përkatëse. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar ikubInfoSoft sh.p.k zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nënligjore në fuqi. 16. Dizënjim, programim, zhvillim, konsulencë, shërbime dhe veprimtari në fushën e aplikimeve GIS dhe WebGIS, punime hartografike, topografike, dhe fotogrametrike, menaxhim i fotove ajrore dhe ortofotove, rrjetet e infrastrukturës, pasuri të paluajtshme, prodhim dhe menaxhim i informacioneve gjeografike dixhitale të të gjitha tematikave, strukturim dhe krijim i bazave të të dhënave hapësinore, zhvillime analizash".

Më 31 dhjetor 2015 Shoqëria kishte 53 punonjës (2014: 36 punonjës).

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

2.1. Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara (SKK) dhe ligjin nr.9228, datë 29 prill 2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Në bazë të urdhrit nr.64 datë 22.7.2014 "Për shpalljen e standardeve kombëtare të kontabilitetit të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre", Ministria e Financave vendosi të bëjë të detyrueshme zbatimin e Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuara duke filluar nga 1 janar 2015.

Ky urdhër hyri në fuqi me fletoren zyrtare nr.119, datë 1 gusht 2014.

2.2. Bazat e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur bazuar në koston historike.

2. Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare (vazhdim)

2.3. Biznesi në vijimësi

Pasqyrat financiare të Shoqërisë përgatiten mbi supozimin e biznesit në vijimësi, i cili merr parasysh se Shoqëria do të vazhdojë ekzistencën e aktivitetit të saj për një të ardhme të parashikuar.

2.4. Monedha funksionale dhe e paraqitjes

Këto pasqyra financiare janë paraqitur në Lek, e cila është dhe monedha funksionale e Shoqërisë.

2.5. Vlerësime dhe gjykime

Paraqitja e pasqyrave financiare kërkon që manaxhimi i shoqërisë të kryejë vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve dhe aktiveve e detyrimeve të kushtëzuara në datën e pasqyrës së pozicionit financiar, si dhe të ardhurave dhe shpenzimeve të krijuara në periudhën kontabël.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën e mëparshme dhe faktorë të tjerë duke përfshirë pritshmëritë për ngjarjet e ardhshme të cilat besohen të jenë të arsyeshme në rrethanat aktuale. Në disa raste manaxhimi mbështetet në mendimet e ekspertëve të pavarur. Manaxhimi kryen vlerësime dhe gjykime në lidhje me të ardhmen. Vlerësimet kontabël që rezultojnë sipas përkufizimit, jo gjithmonë do të barazohen me rezultatet aktuale. Vlerësimet dhe supozimet që kanë risk të rëndësishëm për të shkaktuar korrigjime (axhustime) materiale, të vlerave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve janë përshkruar më poshtë:

2.5.1. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme bazohet në humbjet e vlerësuara të cilat rezultojnë nga pa mundësia e konsumatorëve për të paguar detyrimet e tyre. Këto vlerësime bazohen në moshën e llogarive të arkëtueshme dhe eksperiencën e mëparshme në çregjistrimin, vlerësimin e aftësisë paguese të konsumatorëve, si dhe ndryshimet e fundit dhe të pritshme të termave të pagesës së konsumatorëve. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme.

2.5.2. Provizionet

Provizionet në përgjithësi kërkojnë një nivel të lartë gjykimi, veçanërisht në rastet e konflikteve gjyqësore. Shoqëria vlerëson mundësinë e krijimit të një detyrimi aktual si rrjedhojë e një ngjarje të shkuar, në rast se mundësia e ndodhjes vlerësohet të jetë më shumë se 50% , në të tilla raste shoqëria provizionon vlerën e detyrimit e cila mund të matet me besueshmëri. Për shkak të nivelit të lartë të pasigurisë, në disa raste mund të ndodhë që vlerësimi mund të mos jetë në të njëjtën linjë me rezultatin e çështjes. Manaxhimi vlerëson në fund të çdo periudhe në rast se ka nevojë për krijimin e provizioneve.

2.6. Krahasueshmëria e informacionit kontabël

Siç paraqitet në Standardin Kombëtar të Kontabilitet të përmirësuar nr.1, në rastet e një ndryshimi në paraqitjen e pasqyrave financiare si pasojë e kërkesave të një standardi të ri, një përmirësimi në standard apo një ndryshimi në ligjin për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", informacioni krahasues duhet të riparaqitet për të korresponduar me paraqitjen e re, përveç rasteve kur riparaqitja e informacionit krahasues nuk mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Informacioni krahasues për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është riparaqitur për të korresponduar me paraqitjen e re të pasqyrave financiare siç kërkohet nga Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të përmirësuar.

3. Politikat Kontabël

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në pasqyrat financiare.

3.1. Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale dhe regjistrohen me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivët dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e raportimit konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e bilancit. Fitimi ose humbja nga këmbimi në zëra monetarë është diferenca që vjen nga këmbimi i një numri të caktuar njësisish të një monedhe të huaj në monedhën funksionale me kurse të ndryshme këmbimi në datat e këmbimit. Të drejtat dhe detyrimet jo-monetare në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së kryerjes së transaksionit ndërsa ato që maten me vlerë të drejtë rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat që rezultojnë nga kursi i këmbimit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kursi i këmbimit i monedhave të huaja më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 është detajuar si më poshtë:

Kursi i këmbimit	2015	2014
Euro/Lek	137.28	140.14
USD/ Lek	125.79	115.23
GBP/Lek	186.59	179.48

3.2. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari të arkëtueshme, mjete monetare, hua të marra dhe të dhëna dhe llogari të pagueshme.

Instrumentat financiarë jo-derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Për instrumentat e mbajtur me vlerë të drejtë nëpërmjet fitim/humbjes, kostot e transaksionit kalojnë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiarë jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivët financiarë regjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të shoqërisë mbi flukset e parasë së aktivitetit financiar ose kur shoqëria transferon aktivin financiar tek një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë risqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitetit. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare regjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat në të parë me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së fluksit të parasë, mjetet monetare përfshijnë depozita me afat me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogari të arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provizionit për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar konsiderohen tregues që llogaritë e arkëtueshme të zhvlerësohen. Shuma e provizionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.2. Instrumentat financiarë (vazhdim)

Llogari të pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me vlerën e tyre të drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Hua të marra dhe të dhëna

Huatë e marra dhe të dhëna njihen fillimisht dhe mbahen në vazhdim me vlerën e tregut, pa përfshirë koston e transaksioneve. Pas njohjes fillestare, huatë e marra dhe të dhëna paraqiten me kosto të amortizuar duke njohur në pasqyrën e të ardhurave dheshpenzimeve çdo diferencë midis koston dhe vlerës së pagueshme nominale përgjatë periudhës së huamarrjes duke u bazuar (si rregull) në interesin efektiv. Interesat e njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve janë përlllogaritur mbi bazën e interesit nominal.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të mjeteve monetare dhe ekuivalentëve të tyre, të kërkesave për t'u arkëtuar, detyrimeve për t'u paguar dhe huave, përafrohen me vlerat e tyre kontabël.

Të tjera

Instrumenta të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur çdo humbje nga zhvlerësimi.

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar njihet me vlerën nominale.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuar, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivet financiare të rëndësishme testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivët e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të riskut kreditor.

Të gjitha humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivet financiare të matura me kosto të amortizuar, rimarrja njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

3.3. Inventarët

Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto. Kosto e marrjes përfshin të gjitha shpenzimet e kryera për ta sjellë inventarin në vendin dhe kushtet ekzistuese. Në rastin e prodhimit të produkteve në kosto përfshihet edhe pjesa respektive e shpenzimeve të përgjithshme duke u llogaritur mbi kapacitetet normale prodhuese. Kosto e inventarit llogaritet duke përdorur metodën e mesatares së ponderuar.

Gjendjet e inventarit janë të vlerësuara në bilanc me koston e tyre historike, duke e konsideruar këtë vlerësim, si vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.4. Aktive afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur zhvlerësimin dhe amortizimin e akumuluar.

Kostoja përfshin shpenzime të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kostoja e aktiveve të vetë-ndërtuara përfshin koston e materialeve dhe punës direkte, çdo kosto tjetër të lidhur drejtpërdrejt me sjelljen e aktivit në gjendje pune për qëllimin e synuar të përdorimit, si dhe kostot e çmontimit, heqjes së pjesëve dhe sjelljes në gjendje të mëparshme të vendndodhjes së aktivit. Shpenzimet kapitale të aktiveve të bëra gjatë ndërtimit kapitalizohen në "Ndërtim në proces" dhe transferohen në kategorinë përkatëse të aktivit kur përfundon ndërtimi tij, nga kur aplikohet amortizimi përkatës sipas kategorisë.

Në rastet kur pjesë të një aktivi afatgjatë material kanë jetëgjatësi të ndryshme, ato kontabilizohen si zëra të ndryshëm (komponentët më të mëdhenj) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitjet, apo nxjerrjet jashtë përdorimit përcaktohen duke krahasuar vlerën e shitjes me vlerën e mbetur dhe këto përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

ii. Kostot e mëpasshme

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një zëri të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën kontabël të atij zëri nëse është e mundshme që shoqëria do të realizojë përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i pjesës zëvendësuese dhe kostoja e pjesës mund të matet në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të zakonshme të aktiveve afatgjata materiale njihen si shpenzim kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi

Amortizimi i aktiveve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur të amortizimit mbi jetën e vlerësuar të çdo pjese të aktivit afatgjatë material duke filluar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes. Aktivet e marra me qira amortizohen duke marrë për bazë periudhën më të shkurtër midis periudhës së qirasë dhe jetës së dobishme të aktivit.

Jetëgjatësia e vlerësuar për vitin 2015 dhe 2014 është si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e Amortizimit	Norma e Amortizimit
Mobilje për zyrën	Vlera e mbetur	20 %
Pajisje informatike	Vlera e mbetur	25 %

iv. Çregjistrimi

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo atëherë kur nuk priten më përfitime ekonomike të ardhshme nga përdorimi apo nxjerrja e tij jashtë përdorimit.

Fitimet dhe humbjet në rastin e nxjerrjes jashtë përdorimit të aktiveve afatgjata materiale, përcaktohen sipas shumës së tyre të mbetur dhe merren parasysh në nxjerrjen e rezultatit operativ të vitit.

3.5. Të ardhurat

Të ardhurat njihen atëherë kur është e mundshme që njësia ekonomike do të ketë përfitime ekonomike në të ardhmen dhe këto përfitime mund të maten me besueshmëri. Të ardhurat maten me vlerën e drejtë të arkëtuar ose të arkëtueshme që merr parasysh shumën e çfarëdo zbritje tregtare, zbritjet për shlyerje të menjëhershme dhe zbritjet e bëra për sasi (vëllim) të blerë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.6. Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit paraqesin të ardhurat që përfitohen jo rregullisht gjatë rrjedhës normale të veprimtarisë ekonomike duke përfshirë, fitim/humbjet nga shitja e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, fitim/humbjet nga rivlerësimet e aktiveve afatgjate të investuara dhe fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit përveç diferencave të këmbimit që lidhen me veprimtaritë financiare dhe investuese.

3.7. Qiratë

Qiramarrjet klasifikohen si financiare ose operative që në fillimin e qirasë. Qiratë financiare njihen si aktive dhe detyrime financiare në shkallën më të ulët të vlerës së drejtë të aktivitetit dhe vlerës aktuale të minimumit të pagesave të qirasë në datën e blerjes. Kostot financiare regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve nën termin e qirasë me normat e zbatueshme të interesit mbi balancën e mbetur të detyrimeve.

3.8. Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhura interesi nga llogaritë bankare dhe fitime nga kursi i këmbimit që njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Të ardhurat nga interesi njihen mbi bazën e të drejtave të konstatuara duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzime interesi mbi huamarrjet dhe humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë nëpërmjet llogarisë fitim/humbje dhe humbjet nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me metodën e interesit efektiv.

3.9. Tatimi mbi fitimin

Tatim fitimi i vitit përbëhet nga tatimi aktual dhe tatim fitimi i shtyrë. Tatim fitimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përveç rasteve kur lidhet me zëra që njihen direkt në kapital, rast në të cilin edhe tatimi njihet në kapital.

Tatimi aktual është tatimi i pritur për t'u paguar mbi fitimin e tatueshem të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e bilancit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Norma e tatimit mbi fitimin për vitin 2015 është 15% (2014: 15%).

Tatim fitimi i shtyrë përfaqëson diferencën e tatimit mbi fitimit të pagueshëm (apo të rikuperueshëm) në periudhat e ardhshme, i cili përlllogaritet për të evidentuar diferencat e përkohshme që krijohen për shkak të aplikimit të parimeve kontabël të ndryshme nga ato tatimore. Tatimi i shtyrë njihet sipas metodës së detyrimeve të bilancit, duke aplikuar normën tatimore në fuqi mbi diferencën ndërmjet aktiveve dhe detyrimeve për qëllime të raportimit financiar dhe vlerave të këtyre aktiveve dhe detyrimeve për qëllime tatimore.

Gjendjet e shtyra tatimore maten me normat tatimore në fuqi ose që konsiderohen në fuqi në fund të periudhës së raportimit, të cilat pritet të zbatohen për periudhën kur diferencat e përkohshme do të anulohen ose humbja tatimore e mbartur do të shfrytëzohet.

Aktivitet tatimore të shtyra për diferencat e përkohshme të zbritshme regjistrohen deri në atë masë që është e mundshme që fitimi i tatueshëm në të ardhmen të mund të përdoret për zbritjet në fjalë.

3. Politikat Kontabël (vazhdim)

3.10. Fondet për pensione

Shoqëria paguan kontributet ndaj sigurimeve shoqërore e shëndetësore të detyrueshme, që sigurojnë përfitimet për pensione të punonjësve në përputhje me legjislacionin shqiptar. Autoritetet Fiskale janë përgjegjëse për përcaktimin e kufirit minimal ligjor të vendosur për pensionet në juridiksionin përkatës sipas një plani kontributësh pensioni të përcaktuar.

3.11. Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përcaktohen kur një palë kontrollohet nga pala tjetër, ose ka ndikim të rëndësishëm në vendimet e biznesit apo vendimet financiare të palës tjetër. Për qëllime të paraqitjes së pasqyrave financiare, drejtimi i shoqërisë dhe manaxhimi konsiderohen si palë të lidhura.

3.12. Provizionet

Një provizion njihet nëse, si rezultat i një ngjarjeje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo konstruktiv, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe do të kërkojë në të ardhmen flukse dalëse parash për shlyerjen e tij. Provizionet përcaktohen duke skontuar flukset e pritshme të ardhshme të parasë me një normë skontimi para tatimit që pasqyron vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe për risqet që lidhen me detyrimin në fjalë. Provizionet rishikohen në çdo datë raportimi dhe nëse nuk ka më gjasa për daljen e ndonjë fluksi parash për shlyerjen e detyrimit, provizionet rimerren.

3.13. Aktivet dhe detyrimet e kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato paraqiten në shënime të pasqyrave financiare për sa kohë që mundësia për një dalje të burimeve që përfshijnë përfitime ekonomike është e largët. Një aktiv i kushtëzuar nuk paraqitet në pasqyrat financiare por paraqitet në shënime për sa kohë ekziston mundësia e hyrjes së përfitimeve ekonomike. Shuma e humbjeve të kushtëzuara njihet si provizion, nëse është e mundshme që ngjarjet e ardhshme të konfirmojnë që një detyrim ka lindur në datën e pozicionit financiar dhe mund të bëhet një vlerësim i arsyeshëm i shumës së humbjes.

4. Mjete monetare

Mjetet monetare në arkë dhe bankë detajohen si më poshtë më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Mjete monetare në bankë	101,087,672	80,691,187
Llogari rrjedhëse	101,087,672	80,691,187
Mjete monetare në arkë	104,328	196,683
	<u>101,192,000</u>	<u>80,887,870</u>

5. Llogari të arkëtueshme tregtare

Llogaritë e arkëtueshme tregtare më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Klientë	132,699,011	30,313,812
	<u>132,699,011</u>	<u>30,313,812</u>

“ikubINFO” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

6. Llogari të arkëtueshme nga palët e lidhura

Llogaritë e arkëtueshme nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Të arkëtueshme tregtare nga Infosoftware System shpk	12,104,110	2,673,707
	<u>12,104,110</u>	<u>2,673,707</u>

7. Të tjera llogari të arkëtueshme

Llogaritë të tjera të arkëtueshme më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Tatim mbi fitimin	-	868,073
Garanci për qera	196,000	-
Rimbursime nga Sig.Shoqërore	-	30,046
	<u>196,000</u>	<u>898,119</u>

8. Inventari

Gjendjet e inventarit më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 janë si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Mallra	-	1,800,000
	<u>-</u>	<u>1,800,000</u>

9. Shpenzime të shtyra

Shpenzimet për periudhat e ardhshme më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë :

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Shpenzime të periudhave të ardhshme për sigurim shendetësor	3,312,211	-
	<u>3,312,211</u>	<u>-</u>

“ikubINFO” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

10. Aktive Afatgjata Materiale

	Mobilje orendi	Paisje kompjuterike	Te tjera	Totali
<i>Kosto</i>				
Gjendja më 1 janar 2014	618,975	8,178,038	1,774,102	10,571,115
Shtesa	1,052,500	2,228,209	143,353	3,424,062
Gjendja më 31 dhjetor 2014	1,671,475	10,406,247	1,917,455	13,995,177
Shtesa	736,730	3,075,685	895,469	4,707,884
Gjendja më 31 dhjetor 2015	2,408,205	13,481,932	2,812,924	18,703,061
<i>Amortizimi i akumuluar</i>				
Gjendja më 1 janar 2014	(217,545)	(3,009,402)	(665,548)	(3,892,495)
Amortizimi i vitit	(134,717)	(1,600,489)	(223,519)	(1,958,725)
Gjendja më 31 dhjetor 2014	(352,262)	(4,609,891)	(889,067)	(5,851,220)
Amortizimi i vitit	(344,611)	(1,754,487)	(317,138)	(2,416,236)
Gjendja më 31 dhjetor 2015	(696,873)	(6,364,378)	(1,206,205)	(8,267,456)
<i>Vlera neto kontabël</i>				
Gjendja më 31 dhjetor 2014	1,319,213	5,796,356	1,028,388	8,143,957
Gjendja më 31 dhjetor 2015	1,711,332	7,117,554	1,606,719	10,435,605

“ikubINFO” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

11. Llogari të pagueshme tregëtare

Në këtë zë janë paraqitur detyrimet e palikujduara ndaj furnitorëve për faturat e pranuar dhe ato të pambërritura. Më poshtë janë paraqitur këto detyrime më 31 dhjetor 2015 dhe 2014:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Furnitorë	16,096,439	12,512,086
Furnitorë për fatura të pambërritura	44,513	1,238,081
	<u>16,140,952</u>	<u>13,750,167</u>

12. Llogari të pagueshme ndaj palëve të lidhura

Llogaritë e pagueshme ndaj palëve të lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
ikubINFO Software Solutions	-	181,582
ikub.al	10,120,000	1,761,689
Infosoft Systems Shpk	72,904,171	1,116,072
Romeo Sherko	840,000	-
	<u>83,864,171</u>	<u>3,059,343</u>

13. Detyrime tatimore

Detyrimet tatimore më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 detajohen si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Kontribute për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	1,469,331	1,001,534
Tatimi mbi të Ardhurat nga Punësimi	19,102,320	14,423,980
Tatim në Burim	2,816,405	-
Tatim fitimi	3,996,394	-
TVSH për t'u paguar	22,091,780	3,293,173
	<u>49,476,230</u>	<u>18,718,687</u>

14. Të tjera detyrime

Detyrimet e tjera paraqesin detyrimet ndaj punonjësve dhe detyrime të tjera më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 si më poshtë:

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Detyrime ndaj personelit	43,171,390	43,934,603
Përfitime afatshkurta nga sigurimet	49,375	-
Detyrime të tjera	612,200	70,130
	<u>43,832,965</u>	<u>44,004,733</u>

15. Kapitali

“ikubINFO” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

Kapitali themeltar i Shoqërisë është në vlerë 4,200,000 Lek i zotëruar si më poshtë:

Ortaku	31 dhjetor 2015		31 dhjetor 2014	
	Kuota %	Vlera	Kuota%	Vlera
Investment				
SHERKO	41.5	1,743,000	41.5	1,743,000
Armand Shara	28	1,176,000	28	1,176,000
Elton Ropi	15	630,000	15	630,000
Albano Qojle	15.5	651,000	15.5	651,000
Totali	100	4,200,000	100	4,200,000

16. Të ardhura nga aktiviteti i shfrytëzimit

Të ardhurat nga veprimtaria e zakonshme për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 2014 janë si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga shitja e mallrave	83,497,706	-
Të ardhura nga shërbimet	386,947,078	314,705,293
	470,444,784	314,705,293

17. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit

Të ardhurat e tjera të shfrytëzimit përfshijnë fitim/humbjet që vijnë nga ndryshimi i kursit të këmbimit nga aktiviteti tregtar, të cilat detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Fitime nga këmbimet valutore	418,653	1,266,857
Humbje nga këmbimet valutore	(1,242,907)	(1,131,372)
	(824,254)	135,485

17. Të ardhura të tjera të shfrytëzimit (vazhdim)

“ikubINFO” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

Rakordimi i të ardhurave të deklaruar në FDP e Tatim Fitimit me xhiron e deklaruar në FDP e TVSH është si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më Dhjetor 31, 2015
Rakordimi i të ardhurave me FDP-në	
Shitje total të deklaruar ne FDP TVSH	470,444,784
Shitje të deklaruar në FDP që janë të ardhura në PASH	470,444,784
Shitje mallrash	83,497,706
Shërbime	386,947,078
Të ardhura të deklaruar në PASH të cilat janë deklaruar shitje në FDP	470,444,784
Fitime nga gabime të lejuara në ushtrimet paraardhëse	
Të ardhurat nga interesat	2,988
Të ardhura të tjera financiare	74,604
Fitim nga këmbimet valutore	418,652
Total të ardhura te deklaruar FDP e Tatim Fitimit	470,941,028

18. Lëndët e para dhe shërbimet

Shërbimet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe atë të mbyllur më 31 dhjetor 2014 paraqitet si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shërbime programimi	45,024,454	26,953,793
Shërbime mirëmbajtje	29,201,562	23,766,510
Liçenca	120,883	15,417,833
Kosto e mallrave të shitur	79,962,987	-
	154,309,886	66,138,136

19. Të tjera shpenzime

“ikubINFO” shpk
Shënimet e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

Shpenzimet e tjera detajohen si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Blerje energji	823,551	386,973
Shpenzime komunikimi	615,520	815,541
Reklama, publicitet	223,059	637,793
Konsulencë juridike, ekonomike	746,337	802,640
Siguracione	2,834,906	3,464,282
Shpenzime administrative noteriale	453,765	103,244
Taksa vendore	33,573	25,120
Mirëmbajtje ambiente, pajisje	2,351,954	767,323
Qira zyre	9,250,619	4,821,042
Udhëtime dhe dieta	1,056,435	1,633,964
Kancelari	332,187	127,367
Komisione bankare	358,217	754,501
Trajnime punonjësish	748,960	522,925
Sponsorizime	2,422,990	182,228
Shpenzime për pritje	282,443	11,940
Shpenzime transporti	330,645	132,436
Qera makina	1,870,588	-
Certifikime	490,000	-
Shpenzime të ndryshme dhe të panjohura	1,801,140	2,120,643
	27,026,889	17,309,962

20. Shpenzime të personelit

Shpenzimet e personelit detajohet si më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Shpenzime për paga	127,970,091	117,756,708
Shpërblime	75,632,114	55,989,516
Shpenzime për sigurime shoq e shend	8,845,157	7,303,460
	212,447,362	181,049,684

Numri i punonjësve më 31 dhjetor 2015 është 53 (2014:36).

21. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit

“ikubINFO” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

Shpenzimet e tjera të shfrytëzimit paraqesin gjokat dhe penalitetet për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Gjoka dhe penalitete	5,286	1,243
	5,286	1,243

22. Shpenzime financiare Neto

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
Të ardhura nga interesat	2,987	12,886
Shpenzime financiare	(17)	-
Të ardhura të tjera financiare	74,604	-
	77,574	12,886

23. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Shoqëria është subjekt i tatimit mbi të ardhurat në Shqipëri, norma e të cilit është 15% (2014;15%). Formularët e deklarimit të tatimit mbi të ardhurat paraqiten çdo vit pranë autoriteteve tatimore, por të ardhurat dhe shpenzimet të deklaruara për qëllime të tatueshme konsiderohen vetë deklarime deri në momentin që janë vëzhguar dhe vlerësuar nga autoritetet tatimore.

Legjislacioni tatimor dhe ligjet Shqiptare janë subjekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Përlllogaritja e shpenzimit për tatimin mbi fitimin paraqitet më poshtë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014:

	31 dhjetor 2015	31 dhjetor 2014
Fitimi para tatimit	73,492,447	48,395,914
Shpenzime të panjohura të tjera (si më poshtë)	3,093,070	1,013,278
Sponsorizime mbi normën e lejuar	218,217	
Shpenzime pritje & përcjellje	282,443	11,940
Shpenzime udhëtimi	23,093	159,903
Penalitet, gjoka e dëmshpërblime	5,285	1,243
Shpenzime të tjera	2,564,032	840,192
Fitimi para tatimit (përfshirë shpenzimet e panjohura)	76,585,517	49,409,192
	76,585,517	49,409,192
Tatim fitimi @15%	11,487,828	7,411,379
Fitimi/humbja e Vitit	62,004,619	40,984,535

“ikubINFO” shpk
Shënime e pasqyrave financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015
(Vlerat janë në Lek)

24. Transaksionet me palët e lidhura

Balancat me palët e lidhura më 31 dhjetor 2015 dhe 31 dhjetor 2014 paraqiten si më poshtë:

Pasqyra e pozicionit financiar

	<u>31 dhjetor 2015</u>	<u>31 dhjetor 2014</u>
Te arketueshme nga palet e lidhura		
Infosoft Systems Shpk	12,104,110	2,673,707
	12,104,110	2,673,707
Të pagueshme ndaj palëve të lidhura		
ikubINFO Software Solutions	-	181,582
ikub.al	10,120,000	1,761,689
Infosoft Systems Shpk	72,904,171	1,116,072
Romeo Sherko	840,000	
	83,864,171	3,059,343

Pasqyra e performancës

	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2015</u>	<u>Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014</u>
Shitje ndaj palëve e lidhura		
ikubINFO Software Solutions		5,100,000
Infosoft System shpk	19,136,234	149,523,320
Intellygent System	-	4,000,000
ikub.al	-	1,032,000
	19,136,234	159,655,320
Blerje nga palët e lidhura		
ikubINFO Software Solutions	8,907,119	9,880,355
ikub.al	9,109,726	657,983
Infosoft System shpk	100,449,134	10,986,090
Armand Shara	2,442,223	
Albano Qojle	1,465,334	
Elton Ropi	976,889	
Romeo Sherko	3,081,569	
	126,431,994	21,524,428

Politika e vendosjes së çmimeve për transaksionet me palët e lidhura bëhet në bazë të kushteve të tregut.

25. Angazhime dhe pasiguri

Çështje gjyqësore

Gjatë aktivitetit të saj të zakonshëm, Shoqëria mund të përfshihet në pretendime apo veprime të ndryshme ligjore nga palë të treta. Bazuar në opinionin e drejtuesve të shoqërisë, konkluzioni përfundimtar në lidhje me këto çështje nuk do të ketë efekte negative në pozicionin financiar të Shoqërisë ose ndryshime në aktivet neto të saj. Me 31 dhjetor 2015 Shoqëria nuk ka asnjë çështje gjyqësore të hapur kundrejt saj apo nga ajo, që mund të kërkojë rregullime të këtyre pasqyrave financiare.

26. Ngjarje pas bilancit

Nuk ka asnjë ngjarje pas datës së bilancit e cila kërkon rregullime apo shpjegime në këto pasqyra financiare.

Mazars Sh.p.k

Adresa

Rruga Emin Duraku, Pall. "Binjaket", Nr.5

Tirane, Shqiperi

Tel. +355 (0) 42 278 015

audit@mazars.al

